

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarës E.M.S. rruga “.....” Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.1117-3/15 e dt.17.06.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Bahri Hyseni të dëmtuarit dhe e akuzuara, me dt.02.12.2016, solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara E.M.S., rruga “.....” komuna e Gjilanit, data e lindjes....., në, nga i ati N. e ëma E. e gjinis M., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, ka të kryer fakultetin e shkencave kompjuterike, profesoresh, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes të mesme ekonomike, e pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sespe me date 08.07.2015, rreth ores 12:15, nga Shitmja në drejtim të Ferizajt, e pandehura nga pakujdesia kishte vënë në rrezik jetën dhe trupin e njerëzve, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin tipit Opel Corsa, ngjyrë e kuqe, me targa, në kundërshtim me dispozitën 54.1 të LSKRR-së, duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës humb kontrollin mbi timonin në mënyrë që kishte kaluar në shiritin e majtë qarkullues dhe me pjesën e pare të anës së majtë e kishte goditur automjetin Golf me targa në pjesën e përparme të anës së majtë i cili vinte nga ana e kundërt e të cilën e drejtonte B.P. dhe përveq dëmëve materiale lëndime trupore pëson drejtuesi i automjetit B.P. dhe pasagjerët A.Z. dhe E.Z., të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të dates 10.11.2015.

Me të cilën ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga nen.378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N ME DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarën **E.M.S.** i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej 200 /dyqindë/ Eurosh, të cilin dënim me gjobë është e obliguar ta paguan pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Të dëmtuarit: B.P., A.Z. dhe E.Z. që të tre nga fshati Komuna Vushtrri, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

E akuzuara obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 90,88€ si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1117-3/15 e dt. 17.06.2016, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarën E.M.S., rruga “.....” komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.02.12.2016, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Bahri Hyseni, e akuzuara dhe të dëmtuarit.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se e akuzuara në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar e akuzuara është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së, pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dëmtuarit e të akuzuarës janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarës dhe pasi që gjyqtari është bindur se e njëjta e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtës i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e saj lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

Përkritazi me këtë e akuzuara E.M.S. ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke theksuar se është e vërtetë qka është përshkruar në aktakuzë, kërkoj falje për atë që kam bërë dhe premtoj se veprime të tilla më nuk do të përsëris, ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqyrtimit të sanksionit penal të ketë parasysh pranimin e fajësisë.

I dëmtuari A.Z. deklaroi se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurës ndërsa parashtrij kërkesë pasuroro-juridike të cilën do ta realizoj tek kompania e sigurimeve.

I dëmtuari E.Z. deklaroi se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurës ndërsa parashtrij kërkesë pasuroro-juridike të cilën do ta realizoj tek kompania e sigurimeve.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarës gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni deklaroi se nuk kemi vërejtje në pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, i njëjti pranim është në raport me faktet dhe provat që përmban qështja dhe konform nenit 248 të KPPK-së, i propozojm gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë si dhe gjat matjes së dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe ti shqiptoj një sanksion penal të parapar me ligj.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se e akuzuara pranimin e fajësisë e ka mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale leximi i konstatimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr. N.U. i datës 10.11.2015, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit i datës 06.06.2016, deklarata e të pandehurit e datës. 08.07.2015, deklarata e të dëmtuarit e datës 08.07.2015 si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës e nga të gjitha këto gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

E akuzuara me date 08.07.2015, rreth ores 12:15, nga Shitmja në drejtim të Ferizajt, e pandehura nga pakujdesia kishte vënë në rrezik jetën dhe trupin e njerëzve, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin tipit Opel Corsa, ngjyrë e kuqe, me targa, në kundërshtim me dispozitën 54.1 të LSKRR-së, duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës humb kontrollin mbi timonin në mënyrë që kishte kaluar në shiritin e majtë qarkullues dhe me pjesën e pare të anës së majtë e kishte goditur automjetin Golf me targa në pjesën e përparme të anës së majtë i cili vinte nga ana e kundërt e të cilën e drejtonte B.P. dhe përveq dëmëve materiale lëndime trupore pëson drejtuesi i automjetit B.P. dhe pasagjerët A.Z. dhe E.Z., të përshkruara në ekspozitën mjeko ligjore të dates 10.11.2015.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarës manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit të KPRK së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarën mori pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtës, pendimin për vprën penale të kryer, heqjen dor të ndjekjes penale nga të dëmtuarit, nënë e dy fëmijëve, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 200 /dyqindë/ Eurosh, si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që e akuzuara të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarit: B.P., A.Z. dhe E.Z. që të tre nga fshati Komuna Vushtrri, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve gjyqësore në shumën prej 90,88 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.540/2016 me datë 02.12.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet
ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate